

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214/91500-26-2041-2-1-1&214 26 03 211**

Sa i përket tenderit për **Shërbimet e mirëmbajtjes dhe pastrimit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Erik SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)


L, DARDANIA SU 6/5 C1 NR. 7 PRISHTINE
(Adresa)

PRISHTINE 10000
(Vendi) (Kodi postar)

044/461195
(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

Gentrit Leku
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
erik.shpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

09.07.2026
(Data e parashtrimit të ankesës)


(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate:08.04.2026
Proceverbali i hapjes se tenderit :25.04.2026
Leter standarte per sqarim te tenderit-11.06.2026
Njoftim per dhenje te kontrates -22.06.2026
Kerkesa per qasje -23.06.2026
Lejimi i qasjes -24.06.2026
Kerkese per Rishqyrtim-26.06.2026
Pergjigje per Kërkesën per Rishqyrtim 01.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Në pajtim me nenin 4. Paragrafi 1.26 dhe 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Operatori Ekonomik, brenda afatit të përcaktuar me ligj, ka paraqitur kërkesë për zgjidhje preliminare të mosmarrëveshjes pranë Autoritetit Kontraktues – Akademia për Siguri Publike, duke shteruar mjetin juridik paraprak të paraparë me ligj.

Autoriteti Kontraktues, brenda afatit ligjor, ka nxjerrë vendim me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën tonë për zgjidhje preliminare të mosmarrëveshjes. Me pranimin e këtij vendimi janë përmbushur të gjitha kushtet procedurale të parapara me Ligjin për Prokurimin Publik për ushtrimin e ankesës pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit, andaj kjo ankesë është paraqitur në afatin ligjor sipas neni 109 Afatet për Dorëzimin e Ankesës paragrafi 2

Për rrjedhojë, duke qenë se janë respektuar të gjitha parakushtet procedurale për shqyrtimin e kësaj çështjeje, kërkojmë që Organi Shqyrtues i Prokurimit ta pranojë këtë ankesë si të lejuar dhe të bazuar, si dhe të shqyrtojë në themel të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në vijim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 4 Përkufizimet, paragrafi 1.26 Palë e interesuar
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 1 dhe 4
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale paragrafi 2.4
Neni 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë
Rregullorja për Prokurim Publikë 001/2022 versioni i konsoliduar, Neni 37, par. 37, 1, 2

*** Sipas Neni 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues Akademia e Kosovës për Siguri Publike kishte publikuar Njoftim për Kontratë në Procedurën me të dhënat me titull: Shërbimet e mirëmbajtjes dhe pastrimit me numër të prokurimit 214/91500-26-2041-2-1-1.

Pretendimi,1

Me vendimin e datës 22.06.2026 Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se oferta jonë është e papërgjegjshme me arsyetimin se, pas kërkesës për dorëzimin e mostrave të datës 11.06.2026, produktet me nr. 3, 12 dhe 13 nuk kanë rezultuar të jenë produkte ekologjike dhe, sipas AK-së, kjo bie në kundërshtim me deklaratën tonë për produktet ekologjike.

Konsiderojmë se ky vendim është marrë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik e me kushtet e Dosjes së Tenderit. Pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit, Fletës së të Dhënave të Tenderit dhe Aneksit 1 – Specifikimet Teknike, rezulton se në asnjë dispozitë nuk është përcaktuar: detyrimi për dorëzimin e mostrave; afati për dorëzimin e mostrave; lista e produkteve për të cilat kërkohen mostra; mënyra e testimit të mostrave; kriteret sipas të cilave do të vlerësohen mostrat; apo pasoja juridike në rast të mospranimit të mostrave. Autoriteti Kontraktues nuk mund të krijojë gjatë fazës së vlerësimit një kërkesë të re që nuk ka qenë pjesë e Dosjes së Tenderit.

Per me teper AK ka bere shkelje te RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar neni Neni 37 Mostrat e Tenderëve

37.1 Dokumentet e tenderit në përgjithësi duhet të shmangin kërkesën për paraqitjen e mostrave, pasi kjo kërkesë dekurajon konkurrencën dhe rrit çmimet e ofertës. Përndryshe, tenderuesve duhet t'u kërkohet të konfirmojnë që produkti i tyre plotëson specifikimet e kërkuara dhe në mbështetje të bashkëngjitni çertifikatat e duhura të testimit nga laboratorë të njohur testimi.

37.2 Kur kërkohen mostrat ato mund të dorëzohen paraprakisht, ose gjatë kohës së mbylljes së tenderit. Ato duhet të dorëzohen para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve.

Pretendimi 2

Gjatë fazës së shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, më datë 11.06.2026, Autoriteti Kontraktues, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, i është drejtuar Operatorit Ekonomik me kërkesë për sqarimin e disa çështjeve që i konsideronte relevante për procesin e vlerësimit, me theks të veçantë kërkesën për dorëzimin e mostrave të disa produkteve higjienike të ofertuara.

Në dosjen e tenderit në FTD është kërkuar:

Kërkesa 5 Operator Ekonomik duhet të deklarohet se materialet higjienike të përdorura për pastrim të jenë ekologjike.

Deshmi 5 Të dëshmohet me deklaratë origjinë shkruar dhe e vulosur nga O.E. se të materialet janë ekologjike.

Kërkesa për materiale higjienike ekologjike

Për të realizur këtë kontratë duhet që artikujt me numër rendor : **3,6,9,12 dhe 13** të sillen fizikisht në zyrën e prokurimit mostrat e tyre së bashku me fatura të furnizimeve dhe të dëshmohen që produktet janë ekologjike sipas deklaratave që keni dhënë.

3	Dezinfektues, detergjent për pastrimin e nyjave sanitare (Pllakave, guacave dhe lavamanëve). Domestos ose ekuivalent	copë	60
---	---	------	----

6	Detergjent i lëngshëm	litër	100
9	Detergjent të posaçme për xhama të dritareve	litër	30
12	Material për pastrim i lavamanëve dhe rubineteve me mjete zbardhuese dhe lustrim	litër	20
13	Sapun për duar i lëngshëm	litër	360

Gjithashtu duhen të dëshmohen me fatuara të rregullta të furnizimeve edhe artikujt 1 dhe 2

1	Letër peshqiri për duar, tufë, standarde komercial 1/200 fletëza	copë	1500
2	Letër tualeti 2 ply 1/10	copë	500

Në përputhje me kërkesën e Autoritetit Kontraktues, në brenda afatit të përcaktuar për paraqitjen e sqarimeve dhe dorëzimin e mostrave, kemi dorëzuar në kohë përgjigjen përmes platformës elektronike të prokurimit (e-Prokurimi), si dhe kemi dorëzuar fizikisht mostrat e kërkuara pranë Autoritetit Kontraktues, duke përmbushur në tërësi kërkesat e parashtruara gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

Megjithatë, më datë 22.06.2026, jemi njoftuar me vendimin e Autoritetit Kontraktues përmes të cilit është rekomanduar për dhënie të kontratës një operator tjetër ekonomik.

Duke mos u pajtuar me këtë vendim dhe duke vlerësuar se procesi i vlerësimit nuk ishte zhvilluar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe parimet themelore të transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së ndershme, Operatori Ekonomik ka ushtruar të drejtën e tij ligjore për qasje në dokumentacionin e procedurës së prokurimit, duke kërkuar qasje në ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, si dhe në mostrat e produkteve higjienike të dorëzuara nga ai operator.

Pas miratimit të kërkesës për qasje, përfaqësuesit e kompanisë janë paraqitur fizikisht pranë Autoritetit Kontraktues për të ushtruar të drejtën e inspektimit të dokumentacionit dhe mostrave. Vetëm pas insistimit të vazhdueshëm të përfaqësuesve tanë, Autoriteti Kontraktues ka mundur prezantimin e mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë. Gjatë qasjes, mostrat janë ekzaminuar vizualisht dhe janë dokumentuar përmes fotografive, të cilat

përbëjnë prova materiale dhe do të paraqiten në mbështetje të pretendimeve ankimore të ngritura në këtë ankesë.

Nga ky inspektim janë konstatuar mospërputhje të shumta ndërmjet mostrave të paraqitura dhe kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, si dhe mangësi që vë në dyshim ligjshmërinë dhe objektivitetin e vlerësimit të kryer nga Autoriteti Kontraktues. Përkundër këtyre mospërputhjeve evidente, Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik në fjalë, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe parimet themelore që e rregullojnë procedurën e prokurimit publik.

Nw vendimi e AK oferta e kompanisw sonw wshtw trajtuar si e pabazuar me arsyetimin se mostrat e dorzuara nga ana jonw ekologjike:

Autoriteti Kontraktues ka eliminuar ofertën tonë me arsyetimin se mostrat e dorëzuara për artikujt e kërkuar nuk përfaqësojnë produkte ekologjike. Një arsyetim i tillë është i pabazuar si në aspektin faktik, ashtu edhe në atë juridik, pasi të gjitha mostrat e dorëzuara nga ana jonë janë produkte të cilësisë së lartë dhe ekologjike, gjë që mbështetet nga dokumentacioni teknik i prodhuesve, përfshirë Safety Data Sheet (SDS/MSDS), Technical Data Sheet, si dhe dokumentacioni tjetër përkatës që identifikon produktet dhe karakteristikat e tyre, ndërsa për produktet e certifikuara ekologjikisht edhe nga dokumentacioni përkatës i certifikimit.

Nga ana tjetër, Autoriteti Kontraktues ka pranuar si të rregullta mostrat e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, megjithëse nga shqyrtimi i tyre rezulton se jo për të gjitha produktet evidentohet në mënyrë të qartë përmbushja e kërkesës së dosjes së tenderit, sipas së cilës operatorët ekonomikë ishin të obliguar "të dëshmojnë që produktet janë ekologjike sipas deklaratave të dhëna".

Për më tepër, gjatë analizimit të mostrave të operatorit ekonomik të rekomanduar është konstatuar se për produktin VERDE ECO WC në etiketën e mostrës figuron licenca EU Ecolabel IT/020/025, ndërsa nga informacioni i disponueshëm në regjistrin publik të EU Ecolabel rezulton se i njëjti produkt VERDE ECO WC 750 ml, me barkodin 8007134994863, figuron me licencën IT/020/022. Kjo mospërputhje krijon dyshim objektiv lidhur me identifikimin dhe vlefshmërinë e licencës së paraqitur në mostër dhe impononte detyrimin e Autoritetit Kontraktues për të kryer verifikime shtesë përpara se të konstatonte se kërkesa teknike ishte përmbushur.

Po ashtu, nga mostrat e operatorit ekonomik të rekomanduar rezulton se jo për të gjitha produktet evidentohet qartë certifikimi ekologjik apo ndonjë tregues tjetër i dukshëm që dëshmon karakterin ekologjik të tyre. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar në raportin e vlerësimit apo në vendimin e rekomandimit se mbi çfarë provash konkrete është bazuar për të konstatuar se secili prej produkteve të kërkuara përmbushte kriterin "produkt ekologjik", siç kërkohej shprehimisht në dosjen e tenderit, deklarimin dhe sqarimin e tenderve.

Në këto rrethana, është e qartë se Autoriteti Kontraktues ka zbatuar standarde të ndryshme të vlerësimit për operatorët ekonomikë. Ndërsa ofertën tonë e ka eliminuar me arsyetimin se produktet nuk janë ekologjike, pa vlerësuar në mënyrë të drejtë dokumentacionin teknik të dorëzuar nga ana jonë, ndaj operatorit ekonomik të rekomanduar nuk ka kryer të njëjtin nivel verifikimi dhe nuk ka administruar prova

të mjaftueshme për të dëshmuar se të gjitha mostrat e tij përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit.

Një veprim i tillë është në kundërshtim me parimet e barazisë në trajtim, mosdiskriminimit, transparencës dhe vlerësimit objektiv të ofertave, pasi Autoriteti Kontraktues ka aplikuar kritere të ndryshme për operatorët ekonomikë në të njëjtën procedurë të prokurimit. Për rrjedhojë, eliminimi i ofertës sonë dhe pranimi i ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar janë rezultat i një vlerësimi të pabarabartë, të paarsyetuar dhe të pambështetur në prova të mjaftueshme, për çka vendimi i Autoritetit Kontraktues duhet të anulohet dhe procedura e vlerësimit të ofertave të rivlerësohet në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Foto mostrat e kompanisw sonw




Me qenë së oferta jonë është me çmim me të lartë, çmim të cilin e ka përcaktuar kërkesa për produkte ekologjike dhe të drejtat sociale të të punësuarve e cilat kanë përcaktuar vlerën e oferta jonë financiare do të mbulonte të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Bashjohitur me ankesën të prezantuar faktet të cilat dëshmojnë se mostrat e produkteve tona janë ekologjike dhe të dëshmuara me informacion MSDS.

Oferta e rekomanduar për kontratë do të duhej të trajtohet si e pa përgjegjshme edhe për nga oferta financiare sepse vlera të cilin është rekomanduar nuk arrin të plotësojë kërkesat e ne veqanti kërkesat për materiale higjienike ekologjike. Në kërkesën tonë për të na prezantuar faturat e blerjes së produkteve higjienike të ofertës së rekomanduar nuk na është lëjuar qasje as prezantimi i tyre. Sepse, jemi të bindur se produktet e prezantuara nëse do të vlerësoheshin nga vlera e fatura nëse të njëjtat ekzistojnë operatori ekonomik i rekomanduar do të vlerësohej ofertë e papërgjegjshme, në mungesë të faturave kërkojmë nga aktret të cilët do të jenë pjesë e vlerësimit, krahasimit dhe raportit të ekspertizës të analizojë se a ishin të dorzuar faturat e blerjes së produkteve gjë të cilin e kishte kërkuar Autoriteti Kontraktues në sqarimin e ofertave.

Gjatw qasjws nw dokumentet dhe mostrat e operatorit ekonomik tw rekomanduar, mostrat nuk ishin ekologjike, pas qasjes në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, kemi konstatuar se edhe mostrat e dorëzuara nga ky operator nuk kanë mundur të jenë produkte ekologjike për të gjitha pozicionet e kërkuara. Konkretisht, për produktin nr. 3 "Dezinfektues, detergjent për pastrimin e nyjave sanitare (pllakave, guacave dhe lavamanëve) – Domestos ose ekuivalent", vetë natyra dhe përbërja e produktit si dezinfektues nënkupton praninë e substancave aktive kimike të klasifikuara si të rrezikshme, gjë që dëshmohet edhe përmes fletë-datave të sigurisë (SDS/MSDS). Për rrjedhojë, nëse Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se produktet tona nuk i plotësojnë kriteret ekologjike, i njëjti standard është dashur të zbatohet në mënyrë të barabartë edhe ndaj operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë. Në të kundërtën, kemi të bëjmë me trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë dhe me një vlerësim joobjektiv të mostrave, në kundërshtim me parimet themelore të barazisë, proporcionalitetit dhe transparencës në prokurimin publik.

Foto tw prokuteve të operatorit ekonomik të rekomanduar pwr kontratw:





Autoriteti Kontraktues ka pranuar si të përmbushur kërkesën për produkt ekologjik pa pasur prova të mjaftueshme dokumentare. Vetë emërtimi tregtar "Verde Eco", fotografia e produktit apo shënimet e vendosura në ambalazh nuk përbëjnë dëshmi të vlefshme të përmbushjes së specifikimeve teknike. Në pajtim me parimet e barazisë në trajtim, transparencës dhe verifikimit objektiv të ofertave, përputhshmëria me kërkesën "produkt ekologjik" mund të provohet vetëm përmes certifikatës përkatëse (si p.sh. EU Ecolabel ose ekuivalente) ose dokumentacionit teknik zyrtar të prodhuesit. Në mungesë të këtij dokumentacioni në ofertë, kërkesa teknike nuk mund të konsiderohet e përmbushur dhe oferta është dashur të vlerësohej në përputhje me dosjen e tenderit, deklarin dhe kërkesën për sqarim të ofertave.

Vetë fakti që në etiketën e një produkti figuron mbishkrimi "Eco", "Natural", "Green" apo edhe referenca "EU Ecolabel", nuk përbën automatikisht provë se produkti është ekologjik apo se posedon një licencë të vlefshme ekologjike. Përmbushja e kësaj kërkesë mund të konstatohet vetëm pas verifikimit të autenticitetit dhe vlefshmërisë së licencës ose dokumentacionit përkatës teknik.

Në rastin konkret, gjatë shqyrtimit të mostrës së produktit VERDE ECO WC është konstatuar se në etiketë figuron licenca EU Ecolabel IT/020/025, ndërsa nga regjistri publik i autoritetit kompetent për EU Ecolabel rezulton se i njëjti produkt VERDE ECO WC 750 ml, me barkodin 8007134994863, identifikohet me licencën IT/020/022. Kjo mospërputhje objektive impononte një verifikim të detyrueshëm nga Autoriteti Kontraktues, gjë që nuk rezulton të jetë bërë.

Për më tepër, jo të gjitha mostrat e dorëzuara paraqesin identifikim të qartë të certifikimit ekologjik, ndërsa në procesverbalin e vlerësimit nuk evidentohet se komisioni ka verifikuar vlefshmërinë e licencave ekologjike ose dokumentacionin mbi të cilin është bazuar për të konstatuar se secili produkt përmbush kërkesën për produkt ekologjik.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk ka provuar në mënyrë objektive dhe të dokumentuar se mostrat e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë përmbushin kërkesat teknike të dosjes së tenderit, duke e bërë vlerësimin e tyre të pambështetur në prova të mjaftueshme dhe në kundërshtim me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe vlerësimin objektiv të ofertave.

Kërkesat në aneks 1 të dosjes së tenderit, mostrat e kërkuara numër 3, 6, 9, 12, 13

Nr.	Përshkrimi i materialit	Njësia	Sasia
1	Letër peshqiri për duar, tufë, standarde komercial 1/200 fletëza	copë	1500
2	Letër tualeti 2 ply 1/10	copë	500
3	Dezinfektues, detergjent për pastrimin e nyjave sanitare (Pllakave, guacave dhe lavamanëve). Domestosk ose ekuivalent	copë	60
4	Acid. Chlorhydroic (HCl), 1 l	copë	35
5	Detergjenti pluhur	copë	30
6	Detergjent i lëngshëm	litër	100
7	Materia për pastrimin dhe dezinfektimin e dyshemeve në Klasa, Salla, Kabinete dhe Zyra	litër	200
8	Materia për pastrimin dhe dezinfektimin Inventarit (Klasa, Salla, Kabinete dhe Zyra).	litër	30
9	Detergjent të posaçme për xhama të dritareve	litër	30
10	Kese për mbeturina - Ngjyra e zezë- Mbeturina të zakonshme 120 l	kom. 1/10	400
11	Kese për Mbeturina - Ngjyra e zezë- Mbeturina të zakonshme 35 l	kom. 1/20	120
12	Material për pastrimi i lavamanëve dhe rubineteve me mjete zbardhuese dhe lustrim	litër	20
13	Sapun për duar i lëngshëm	litër	360

Mostrat e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të dosjes së tenderit. Sipas Aneksit 1 të dosjes së tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që për artikujt me numër rendor 6, 12 dhe 13 mostrat të dorëzohen për produkte me njësi matëse litër (L). Megjithatë, operatori ekonomik i rekomanduar ka dorëzuar mostra me vëllim 750 ml, të cilat nuk korrespondojnë me specifikimin teknik të kërkuar dhe, rrjedhimisht, nuk përfaqësojnë produktin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Për rrjedhojë, pranimi i mostrave pa një verifikim të plotë, objektiv dhe të dokumentuar përbën shkelje të nenit 7, nenit 28 dhe nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe cenon parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe ligjshmërisë në procedurën e prokurimit publik.

Pretendimi, 3

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, kemi konstatuar se Deklarata e Specifikimeve Teknike e dorëzuar nga ky operator nuk është përgatitur për aktivitetin e prokurimit objekt të kësaj procedure, pasi në përmbajtjen e saj figuron referencë ndaj një aktiviteti tjetër të prokurimit. Si rrjedhojë, dokumenti nuk identifikon qartë procedurën për të cilën është dorëzuar dhe krijon paqartësi serioze lidhur me vlefshmërinë, dedikimin dhe besueshmërinë e tij si provë për përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Një dokument teknik që i referohet një aktiviteti tjetër të prokurimit nuk mund të konsiderohet automatikisht si dokument i vlefshëm për procedurën në shqyrtim, pasi

nuk garanton se deklaratimet e përfshira në të janë dhënë për këtë aktivitet të prokurimit dhe për kërkesat konkrete të Autoritetit Kontraktues.

Në pajtim me nenin 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues ka detyrimin të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse dokumentacioni i dorëzuar nga operatorët ekonomikë është në përputhje me të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit. Gjithashtu, sipas nenit 7 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të zbatojë parimin e trajtimit të barabartë dhe të vlerësojë të gjithë operatorët ekonomikë sipas të njëjtave standarde dhe kritere.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka zbatuar një standard jashtëzakonisht rigoroz ndaj ofertës sonë, duke e konsideruar çdo mospërputhje të pretenduar si bazë për eliminim, ndërsa ndaj operatorit ekonomik të rekomanduar ka toleruar një dokument që i referohet një aktiviteti tjetër të prokurimit, pa evidentuar asnjë verifikim apo kërkesë për sqarim. Një trajtim i tillë përbën cenim të parimit të trajtimit të barabartë dhe të vlerësimit objektiv të ofertave.

Për rrjedhojë, kërkojmë që Organi Shqyrtues i Prokurimit të konstatojë se Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar standarde të njëjta të vlerësimit ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë dhe të urdhërojë rivlerësimin e dokumentacionit të operatorit ekonomik të rekomanduar, duke verifikuar nëse Deklarata e Specifikimeve Teknike është përgatitur dhe dorëzuar në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe i referohet në mënyrë të qartë aktivitetit të prokurimit objekt të kësaj procedure.

Pretendimi 4

Gjatë analizës së strukturës financiare të ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, konstatohet se ky operator ka kryer kalkulim të gabuar të kostos së pushimit vjetor për punonjësit, duke e bazuar atë vetëm në pagën bruto prej 500.00 €, pa përfshirë kontributin e detyrueshëm prej 5% të punëdhënësit në Fondin e Kursimeve Pensionale, i cili përbën pjesë të detyrueshme të kostos së punës që bart punëdhënësi.

Në përputhje me nenin 32 të Ligjit Nr. 03/L-212 për Punën, punëmarrësi gjatë pushimit vjetor gëzon të drejtën e kompensimit në lartësinë e pagës që do të kishte përfitur sikur të ishte në punë. Kjo nënkupton se kostoja reale e pushimit vjetor duhet të llogaritet mbi koston e plotë të punës, e cila përfshin jo vetëm pagën bruto, por edhe kontributet e detyrueshme që punëdhënësi paguan sipas legjislacionit në fuqi.

Në rastin konkret, operatori ekonomik ka paraqitur vlerën 41.67 € për pushimin vjetor, ndërsa vlera reale, duke përfshirë edhe kontributin prej 5% të punëdhënësit, do të duhej të ishte 43.75 € për çdo punonjës. Kjo diferencë, ndonëse në dukje e vogël në nivel mujor, shumëzohet me numrin e punonjësve dhe me kohëzgjatjen 36-mujore të kontratës, duke krijuar një mungesë të konsiderueshme në mbulimin e kostove reale të kontratës.

Për pasojë, analiza financiare e operatorit ekonomik të rekomanduar nuk pasqyron koston reale të implementimit të kontratës dhe paraqet një ofertë të nënvlerësuar artificialisht. Kjo ngre dyshime serioze se oferta është anormalisht e ulët, në kuptim të nenit 61 të Ligjit për Prokurimin Publik, pasi nuk reflekton të gjitha kostot e detyrueshme ligjore që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

Autoriteti Kontraktues kishte detyrimin ligjor që, para rekomandimit për dhënie të kontratës, të analizonte nëse oferta mbulon të gjitha detyrimet ligjore dhe financiare që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, përfshirë kostot e personelit, kontributet e detyrueshme dhe të gjitha elementet e domosdoshme për realizimin e kontratës. Mosidentifikimi i këtij kalkulimi të gabuar dhe moszbatimi i procedurës së paraparë për shqyrtimin e ofertës anormalisht të ulët përbën shkelje të nenit 61 në lidhje me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Për më tepër, nënvlerësimi i kostove të personelit ndikon drejtpërdrejt në aftësinë financiare të operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit, veçanërisht në furnizimin me materiale higjienike ekologjike, realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes së kopshtarisë, si dhe përmbushjen e të gjitha kërkesave teknike të përcaktuara në Aneksin 1. Në këto rrethana, ekziston një rrezik real që kontrata të mos mund të zbatohet në përputhje me kushtet e saj, pikërisht për shkak se oferta nuk mbulon kostot minimale të detyrueshme të ekzekutimit.

Për këto arsye, kërkojmë që Organi Shqyrtues i Prokurimit të konstatojë se Autoriteti Kontraktues nuk ka kryer një analizë të plotë dhe objektive të strukturës financiare të ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar dhe të urdhërojë rivlerësimin e ofertës, duke zbatuar dispozitat e nenit 61 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Duke u bazuar në të gjitha faktet, provat dhe argumentet e paraqitura në këtë ankesë, propozojmë që Organi Shqyrtues i Prokurimit ta aprovojë ankesën tonë si të bazuar, ta anulojë Vendimin për Dhënie të Kontratës dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që të bëjë rivlerësimin e ofertave në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit, duke siguruar një vlerësim të plotë, objektiv, të paanshëm.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet mbi angazhimin në përgatitjen e ofertës, sigurimi i ofertës, koha e humbur, ngakesa dhe stresi, fitimi i humbur

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, originalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*